REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 337, Datë 06.11.2026

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË "KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SH.A KESH)" SH.A. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TEC-ET LUNDRUESE "TIGRI 1", ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 MW, DHE "TIGRI 3", ME KAPACITET TË INSTALUAR 60 MW

Në mbështetje të neneve 16, 40, pika 2, gërma "a", 41, pika 1, gërma "a" dhe 136, pika 2 të ligjit nr. 59/2026 *"Për sektorin e energjisë elektrike"*; neneve 4, pika 1, gërma "a", 5, pika 1, gërma "a", 13, si dhe 14, pika 9 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.11.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1950/39 prot., datë 04.11.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi kërkesën e shoqërisë "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (SH.A KESH)" sh.a. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-et lundruese "Tigri 1", me kapacitet të instaluar 50 MW, dhe "Tigri 3", me kapacitet të instaluar 60 MW*",

Konstatoi se:

- Shoqëria "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (Sh.a KESH)" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1950 prot., datë 23.06.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-et Lundruese "Tigri 1", me kapacitet të instaluar 50 MW, dhe "Tigri 3", me kapacitet të instaluar 60 MW, me vendndodhje në Portin e Triportit, në Gjirin e Vlorës. Bazuar ndër të tjera në përcaktimet e kontratës së qirasë, operimit dhe mirëmbajtjes, *Bareboat Charter and O & M Services Agreement* nr. prot 1660/1, datë 04.04.2022, amenduar me kontratën nr.1660/7, datë 07.04.2022, nenet 14 dhe 16, sipas të cilës, me përfundimin e afatit 2-vjeçar të kontratës së qirasë, shoqëria KESH sh.a. fiton të drejtat mbi pronësinë e asetit.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 185, datë 06.07.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 07.07.2026 dhe 08.07.2026). Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Rezulton se procedura ka filluar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 185, datë 06.07.2026, në kushtet kur ishte në fuqi ligji nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", i ndryshuar. Për rrjedhojë, veprimet procedurale të kryera deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", më datë 15.07.2026, janë realizuar në përputhje me kuadrin ligjor të kohës.
- Ndërkohë, vijimi i shqyrtimit dhe vendimmarrja përfundimtare janë mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 59/2026, ndërsa aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit të mëparshëm janë zbatuar për aq sa nuk bien në kundërshtim me ligjin e ri dhe deri në miratimin e akteve të reja.

Në këtë mënyrë, procedura është zhvilluar në respektim të kuadrit ligjor të zbatueshëm në secilën fazë të saj.

- Në vijim, gjatë shqyrtimit të aplikimit, ERE zhvilloi korrespondencën përkatëse me shoqërinë për plotësimin e dokumentacionit, si dhe me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) dhe "Operatorin e Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a., me qëllim verifikimin dhe sqarimin e çështjeve që lidhen me të drejtën për ushtrimin e veprimtarisë.
- Në kuadër të kësaj korrespondence, një nga çështjet që kërkonte sqarim që lidhej me vlefshmërinë e lejes mjedisore për operimin e TEC-eve lundruese "Tigri 1" dhe "Tigri 3". Nga informacioni i përcjellë nga AKM-ja rezultonte se KESH sh.a. dispononte një leje mjedisi me kod III.1.C dhe PN-1673-03-2023, ndërkohë që dokumentacioni i administruar nuk sqaronte nëse kjo leje mbulonte operimin e impianteve në kushtet e ndryshimit të statusit juridik të aseteve pas përfundimit të kontratës së qirasë. Për këtë arsye, ERE iu drejtua përsëri AKM-së, duke kërkuar një qëndrim konkret nëse leja ekzistuese ishte e vlefshme për operimin e TEC-eve apo nëse shoqëria duhej të pajisej me leje ose akte të tjera mjedisore, sipas legjislacionit në fuqi. Duke qenë se vlerësimi i vlefshmërisë së lejeve mjedisore nuk përfshihet në kompetencat ligjore të ERE-s dhe kjo çështje nuk ishte sqaruar në mënyrë përfundimtare, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 254, datë 03.09.2026, vendosi pezullimin e procedurës administrative të licencimit, deri në administrimin e qëndrimit të AKM-së lidhur me lejen/lejet mjedisore të nevojshme për operimin e dy TEC-eve lundruese.
- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1940/34 prot., datë 25.09.2026, KESH sh.a. ka depozituar në ERE, ndër të tjera dhe Akt-miratimin e lejes së mjedisit tip A, nr. 5216 prot., datë 23.09.2026, të Ministrisë së Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
  Në pikën 1.5 të kësaj leje është përcaktuar detyrimi i shoqërisë për të njoftuar me shkrim AKM-në si autoriteti kompetent në lidhje me marrjen e masave përkatëse, ndaj me shkresën nr. 1950/37 prot., datë 08.10.2026, ERE ka kërkuar nga shoqëria KESH sh.a. informacionin përkatës në lidhje me zbatimin e këtij detyrimi.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1950/38 prot., datë 30.10.2026, shoqëria ka vënë në dispozicion të ERE-s shkresën drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në kuadër të masave të marra në zbatim të sa përcaktuar në këtë leje.
  Në kushtet kur KESH sh.a. ka depozituar lejen e re mjedisore dhe korrespondencën vijuese në zbatim të saj, në përputhje me sa përcaktuar në vendimin nr. 254, datë 03.09.2026, vlerësohet se arsyeja e pezullimit është ezauruar dhe, në referencë të përcaktimeve të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike,* procedura administrative duhet të vijojë me shqyrtimin e kërkesës për licencim.
- Për gjithë sa më sipër, nga analiza e aplikimit dhe e të gjithë dokumentacionit të administruar në kuadër të procedurës së licencimit, përfshirë dokumentacionin plotësues të depozituar nga shoqëria dhe aktet e institucioneve kompetente, rezulton si vijon:

Marrëdhënia kontraktore dhe kalimi i të drejtave mbi TEC-et lundruese "Tiger 1" dhe "Tiger 3" mbështetet në:

- *Kontratën "Bareboat" dhe Marrëveshjen e Shërbimeve O&M, nr. 1660/1 prot., datë 04.04.2022, e nënshkruar ndërmjet KESH sh.a., shoqërisë "EXELERATE GLOBAL OPERATIONS" L.L.C. dhe "RENCO" S.P.A., nëpërmjet së cilës është parashikuar dhënia me qira e dy njësive termike lundruese "Tiger I" dhe "Tiger III", për operimin e tyre në Portin e Vlorës, ndryshuar me me Amendamenti nr. 1. 1660/7 prot., datë 07.04.2022, nëpërmjet të cilit është përcaktuar se periudha e kontratës përfundon dy vjet pas datës së dorëzimit, me mundësi zgjatjeje sipas kushteve kontraktore, si dhe detyrimi i KESH sh.a. për blerjen dhe marrjen në*

dorëzim të objektit në datën e përfundimit, duke parashikuar transferimin te KESH sh.a. e të gjitha të drejtave përfituese dhe ligjore, titullit dhe interesit mbi objektin.

- *Kontratën e Kalimit të të Drejtave Reale, nr. Rep. 4935, nr. Kol. 1131, datë 02.09.2026, e nënshkruar ndërmjet "Excelerate-Renco FPB" sh.p.k., në cilësinë e shitësit/transferuesit, dhe KESH sh.a., në cilësinë e blerësit/marrësit të transferimit, me objekt kalimin e të drejtave reale mbi dy centralet elektrike të montuara mbi anije dhe të furnizuara me HFO, të njohura si "Tiger I" dhe "Tiger III".*
- MIE me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1950/16 prot., datë 05.08.2026, ka shprehur qëndrimin e saj, duke përcaktuar se "*Referuar parashikimeve të kontratës së qirasë, operimit dhe mirëmbajtjes "BAREBOAT" dhe Marrëveshje për Shërbimet O & me, me nr. 1660 prot., datë 04.04.2022, amenduar me kontratën Nr. 1660/7 Prot., datë 07.04.2022, me përfundimin e afatit të qirasë, asetet termike kalojnë në pronësi të KESH sh.a., në përputhje me nenet 15 dhe 16 të kontratës. Në këto kushte, e ndryshimi i natyrës juridike të asetit është parashikuar shprehimisht në kontratë, në përputhje me kushtet e saj për kalimin e pronësisë dhe si i tillë nuk përbën dhënien e një të drejtë për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese dhe të depozitimit të energjisë, të cilat nuk janë objekt koncesioni sipas përcaktimeve të nenit 52 të ligjit nr. 59/2026 "Për sektorin e energjisë elektrike"".*
- Shoqëria "KESH" sh.a. ka nënshkruar me OST sh.a. Amendimin nr. 1, të Marrëveshjes për lidhjen me rrjetin e transmetimit të dy njësive gjeneruese termike (TEC) lundruese, me nr. 5667 prot., datë 14.09.2026 dhe me KESH sh.a. me nr. 4323/1 prot., datë 23.09.2026, ku referohet ndryshimi i pronësisë mbi asetet TEC Lundruese dhe kalimin e tyre tek KESH sh.a. Kjo marrëveshje lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
- Shoqëria diponon Leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor me nr. Serie 000047, nr. 5/7 prot., datë 15.03.2023, miratuar me Vendimin e Këshillit të Basenit Ujor nr. 3, datë 13.03.2023, për shoqërinë "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (Sh.a KESH)" sh.a., për llojin e aktivitetit dhe qëllimin për të cilin do të përdoret uji: *"Për procesin e ftohjes së Impiantit Termik Lundrues të Përkohshëm, Triport, Vlorë"*. Periudha e vlefshmërisë së kësaj leje është 5 vite deri më 15.03.2028 dhe brenda këtij afati shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar.
- Shoqëria është pajisur me Akt miratimi Leje Mjedisi Tipi A, lejes Nr. 5216 prot., datë 23.09.2026, me numër identifikimi të Lejes 4407/1, K. Nr. 42, për Subjektin "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (Sh.a KESH) (LC - 5574)", me titull *"Industritë Energjitike, Trajtimi i ujërave dhe ujërave të zeza"*. Me përshkrim të veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues: ***ID 1.1,*** *instalimet me djegie.* ***ID 6.1*** *Instalim trajtimi për ujëra të ndotura urbane.* ***ID 6.2*** *Trajtimi i ujërave të ndotura industriale në vendin ku krijohen. Kapaciteti i projektuar është 110MWe"*, me vendndodhje Qarku Vlorë, bashkia Vlorë, Njësia Administrative Qendër Vlorë, Nartë, Triport Zona Kadastrale 8604.
- Shoqëria KESH sh.a. ka dokumentuar po ashtu përmbushjen e kërksave të rregullores, në lidhje me kapacitet financiare, administrative dhe juridike ushtrimin e veprimtarisë.
- Po ashtu, ERE ka bërë njoftimin në median e shkruar, në faqen zyrtare të internetit dhe në rrjetet sociale për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë, ku brenda afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve (brenda datës 05.08.2026), rezulton se në ERE janë paraqitur objeksione (të grupuara sipas cështjeve) si vijon:
- E. R. (me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 2108 prot., datë 13.07.2026); L. Q. (me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 2109 prot., datë 13.07.2026); M.N. dhe H. N. (me e-mailet e protokolluara në ERE me nr. 2110 prot., datë 13.07.2026); L. M. (me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 2110/1 prot., datë 14.07.2026); F. B. (me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 2110/2 prot., datë 14.07.2026); S. Gj., me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 2110/3 prot., datë 14.07.2026, L. P. (me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 2110/4 prot., datë 14.07.2026,

si dhe me e-mailin e dërguar më 05.08.2026, protokolluar në ERE me nr. 2110/15 prot., datë 06.08.2026); D. M. (me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 2110/5 prot., datë 14.07.2026); E. L. (me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 2110/6 prot., datë 14.07.2026); D. S. (Shoqata "Arta", me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 2110/7 prot., datë 15.07.2026), E. D. (me e-mailin e protokolluar me nr. 2110/10 prot., datë 31.07.2026); L. F. (Shoqata e Bujqësisë Organike dhe Mjedisit, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2110/11 prot., date 31.07.2026); E. N. (me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 2110/12 prot., datë 31.07.2026); Grupi qytetar "Shpëto Vlorën", përfaqësuar nga Av. M. N. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2110/13 prot., datë 03.08.2026); A. B., me e-mailin e datës 05.08.2026, protokolluar në ERE me nr. 2110/16, datë 06.08.2026; A. Sh., (me e-mailin e datës 05.08.2026, protokolluar në ERE me nr. 2110/17 prot., datë 06.08.2026).

- Në mënyrë më të detajuar, objeksionet e ngritura lidhen me çështje si vijon:
Objeksione lidhur me ndikimin në mjedis, ndotjen e ajrit, emetimet atmosferike, zhurmat, ujërat e ftohjes, shkarkimet në det, ekosistemin ujor dhe shëndetin e qytetarëve

  - Ndotjen e ajrit dhe emetimet atmosferike, të lidhura me përdorimin e lëndëve djegëse fosile, veçanërisht fuel oil/naftë të rëndë, si dhe me pretendime për çlirimin e gazeve serrë, dioksidit të squfurit, grimcave dhe ndotësve të tjerë. Në disa objeksione janë referuar edhe episode të perceptimit të tymit të dendur dhe erës së rëndë të karburantit gjatë funksionimit ose testimit të impianteve.
  - Ndikimin e pretenduar në shëndetin publik, duke u shprehur shqetësime se emetimet atmosferike dhe ndotësit e tjerë të lidhur me aktivitetin mund të ndikojnë në shëndetin e banorëve dhe në cilësinë e jetës në zonën e Vlorës.
  - Ndikimin në mjedisin detar dhe cilësinë e ujërave, veçanërisht lidhur me përdorimin e ujit të detit për ftohje dhe shkarkimin e ujërave të ngrohta, si dhe me mundësinë e shkarkimit të substancave kimike, karburanteve, vajrave industrialë apo substancave të tjera ndotëse në Gjirin e Vlorës. Në këtë kuadër janë ngritur shqetësime për ndryshimin e parametrave të mjedisit ujor dhe pasojat e mundshme në ekosistemin detar.
  - Ndikimin në biodiversitet, florë dhe faunë, duke u pretenduar se shkarkimet në det, ndryshimet e temperaturës së ujërave dhe emetimet e aktivitetit mund të dëmtojnë habitatet ujore, mikroorganizmat, peshqit dhe organizmat e tjerë detarë, si dhe bimësinë dhe pishat në zonën përreth.
  - Ndotjen akustike dhe mbetjet teknologjike, të cilat, sipas disa objeksioneve, përbëjnë shqetësime shtesë për mjedisin dhe komunitetin lokal.
  - Përputhshmërinë me kërkesat dhe lejet mjedisore, ku është ngritur nevoja që, përpara licencimit, të verifikohet përmbushja e të gjitha kërkesave ligjore dhe mjedisore, vlefshmëria e lejeve përkatëse dhe respektimi i kushteve të tyre, si dhe ndikimi faktik i aktivitetit në mjedis.
  - Ndikimin në zhvillimin e zonës së Triportit dhe në turizëm, duke u argumentuar se prania dhe operimi i impianteve lundruese cenon potencialin turistik, rekreativ dhe ekonomik të zonës, si dhe imazhin e qytetit të Vlorës. Në disa objeksione është vlerësuar se ndikimi nuk është vetëm mjedisor, por edhe viziv dhe socio-ekonomik.
  - Interesin publik dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Vlorës, duke u theksuar karakteri turistik dhe vlerat natyrore të qytetit, si dhe nevoja që vendimmarrja për licencimin të marrë në konsideratë mbrojtjen e mjedisit, shëndetit publik dhe interesit të komunitetit.

  - Në disa prej paraqitjeve janë kërkuar gjithashtu transparencë, verifikim i pavarur i ndikimeve mjedisore, përfshirje e komunitetit në dëgjesa publike, si dhe, në një rast, largimi i impianteve nga Gjiri i Vlorës dhe kryerja e një procedure të re dhe më të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.
- Për sa i përket dokumenteve të paraqitura në emër të qytetarëve, komunitetit apo diasporës, në rastet kur është depozituar dokumentacioni përkatës që provon tagrin e përfaqësimit, ato janë marrë në konsideratë në kuadër të procedurës administrative, ndërsa për rastet kur një dokument i tillë përfaqësimi nuk është paraqitur, pretendimet e personave të tjerë të identifikuar nuk janë marrë në konsideratë si të paraqitura nëpërmjet përfaqësuesit.
- Në referencë të përcaktimeve të nenit 10, pika 13 të Rregullores, ERE i ka dërguar KESH sh.a. objeksionet e ardhura si më sipër, përkatësisht nëpërmjet shkresave 1950/9 prot., datë 17.07.2026, nr. 2110/18 prot. datë 07.08.2026, nr. 2110/21 prot., datë 10.08.2026, nr. 2110/22 prot., datë 10.08.2026, nr. 2110/24 prot., datë 10.08.2026.
  - KESH sh.a. ka depozituar parashtrimet e tij, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1950/13 prot., datë 03.08.2026, nr. 1950/17 prot., datë 06.08.2026, nr. 2110/23 prot., datë 10.08.2026, nr. 1950/27 prot., datë 27.08.2026 dhe nr. 2110/25 prot., datë 19.08.2026.

<u>Parashtrimet e KESH-it në lidhje me objeksionet/çështjet e sipërcituara</u>

Në përgjigje të objeksioneve, KESH sh.a. i ka mbështetur parashtrimet kryesisht në Lejen Mjedisore Tipi A PN-1673-03-2023, dokumentacionin teknik të impianteve, raportet periodike të vetëmonitorimit të depozituara pranë AKM-së, të dhënat e monitorimit të shkarkimeve dhe legjislacionin mjedisor në fuqi. Shoqëria thekson se vlerësimi i ndikimeve të pretenduara nuk mund të mbështetet vetëm në perceptime apo vlerësime të përgjithshme, por duhet të bazohet në të dhëna të matshme, rezultate laboratorike dhe monitorime konkrete.

Konkretisht, KESH sh.a. parashtron se:

- Aktiviteti është i pajisur me leje mjedisore, e cila përcakton aktivitetet e autorizuara, vendndodhjen, kapacitetin, pikat e shkarkimit, detyrimet për vetëmonitorim, frekuencën e raportimit dhe kushtet teknike për kontrollin e ndikimeve në mjedis. Shoqëria thekson gjithashtu se AMBU, me vendimin nr. 3/2023, ka miratuar lejen për vendndodhjen në Triport për një afat 5-vjeçar.
- Shkarkimet atmosferike i nënshtrohen monitorimit periodik. KESH sqaron se impiantet kanë 19 pika shkarkimi në ajër, A1–A19, dhe se, sipas raporteve të vetëmonitorimit për periudhën gusht 2024 – 14 maj 2026, parametrat e monitoruar kanë rezultuar brenda vlerave kufi të përcaktuara në lejen mjedisore dhe në aktet normative të referuara nga shoqëria.
- Lidhur me konsumin e karburantit, KESH argumenton se ai nuk përbën një vlerë fikse dhe varet nga regjimi i operimit, ngarkesa e prodhimit, orët e punës, kërkesa e sistemit, rendimenti, mirëmbajtja, lloji dhe cilësia e lëndës djegëse dhe faktorë të tjerë teknikë e operacionalë.
- Për erën dhe perceptimin e tymit, shoqëria shprehet se perceptimi i erës nuk është në vetvete i mjaftueshëm për të përcaktuar burimin, intensitetin apo përbërjen e ndotësit. Sipas saj, një vlerësim i tillë kërkon të dhëna mbi operimin e impiantit, kushtet meteorologjike, burimet e tjera të mundshme të emetimeve dhe matje konkrete të cilësisë së ajrit.
- Për ndikimin në shëndetin publik, KESH argumenton se ky vlerësim duhet të mbështetet në të dhëna të cilësisë së ajrit, vlerësime të ekspozimit dhe ekspertizë të institucioneve kompetente të shëndetit publik. Për parametrat e ujërave dhe shkarkimeve, shoqëria referon rezultatet e vetëmonitorimit, sipas të cilave parametrat e analizuar kanë rezultuar nën ose brenda vlerave të referuara në aktet përkatëse.

- Për ujërat e ftohjes, KESH sqaron se shkarkimet janë të parashikuara në dokumentacionin mjedisor dhe se janë identifikuar dy pika shkarkimi, U1 dhe U2, të cilat përfshihen në monitorimin faktik të impiantit. Sipas raporteve të paraqitura nga shoqëria në AKM, parametrat e monitoruar të ujërave kanë rezultuar brenda vlerave të lejuara/rekomanduara të referuara prej saj.
- Për biodiversitetin detar, KESH vlerëson se një pretendim për dëmtim nuk mund të konsiderohet i provuar vetëm mbi bazën e mundësisë së një ndikimi. Sipas saj, kërkohen të dhëna mbi gjendjen fillestare të habitatit, monitorime biologjike periodike, analiza të parametrave të ujit, vlerësim të temperaturës dhe zonës së përzierjes, identifikim të specieve të prekura dhe provë të lidhjes shkakësore ndërmjet shkarkimit dhe dëmit të pretenduar.
- Për zhurmën, shoqëria referon rezultatet e monitorimit, duke bërë dallimin ndërmjet LAmax dhe LAeq, dhe evidenton se, ndërsa LAmax rezulton nën vlerën e referuar prej saj, në disa raste niveli ekuivalent LAeq gjatë ditës ka rezultuar mbi vlerën 70 dBA.
- Për ndikimin në turizëm dhe zhvillimin e zonës, KESH argumenton se këto janë çështje me karakter socio-ekonomik, territorial dhe strategjik dhe nuk përcaktojnë, në vetvete, përputhshmërinë mjedisore të aktivitetit. Sipas shoqërisë, çështjet e përdorimit alternativ të zonës, zhvillimit turistik dhe destinacionit portual i përkasin institucioneve kompetente në këto fusha.
- Në përfundim, KESH sh.a. thekson se shqetësimet e ngritura duhet të vlerësohen mbi bazën e dokumentacionit administrativ dhe teknik, kushteve të lejes mjedisore, rezultateve të monitorimit dhe të dhënave laboratorike, dhe jo vetëm mbi bazën e pretendimeve të përgjithshme. Shoqëria sjell gjithashtu në vëmendje se një pjesë e shqetësimeve të ngritura në objeksione janë trajtuar më parë në kuadër të një procesi gjyqësor, duke iu referuar ekspertimit të kryer në atë proces dhe Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 3600, datë 23.10.2025, me të cilin është rrëzuar kërkesë-padia.
- Referuar këtij vendimi dhe aktit të ekspertimit të administruar në kuadër të këtij gjykimi, rezulton se vlerësimi është kryer mbi bazën e matjeve faktike dhe krahasimit të parametrave mjedisorë me vlerat e përcaktuara në Deklaratën Mjedisore/Lejen e Mjedisit dhe legjislacionin në fuqi.
- Nga akti i ekspertimit rezulton se, në tërësi, parametrat e monitoruar lidhur me zhurmat, shkarkimet atmosferike, gazrat dhe grimcat, si dhe parametrat kimikë dhe fiziko-kimikë të ujërave, kanë rezultuar brenda vlerave kufi të përcaktuara nga legjislacioni mjedisor. Eksperti ka vlerësuar gjithashtu se, për sa kohë parametrat mjedisorë të monitoruar qëndrojnë në nivelet e konstatuara, nuk evidentohet ndikim negativ në florën dhe faunën.
- Në përfundim, bazuar në aktin e ekspertimit dhe provat e administruara gjatë gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë.
- Lidhur me aktet e Bashkisë Vlorë dhe Këshillit Bashkiak Vlorë, shoqëria ka informuar se ka depozituar në ERE faturën e datës 15.10.2024 dhe dokumentin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe Lejes Infrastrukturore (datë 15.10.2024) për objektin “Impianti termik notues i përkohshëm dhe infrastruktura ndihmëse në Triport, Vlorë”, ndërsa ka deklaruar se nuk disponon dokumentacion tjetër lidhur me akte apo qëndrime të këtyre organeve për projektin.

Qëndrimi i ERE-s në lidhje me objeksionet/çështjet e sipërcituara

- Në lidhje me pretendimet e ngritura për ndikimin në mjedis, ERE vlerëson të sqarojë se gjatë procedurës është shqyrtuar dokumentacioni dhe aktet e nxjerra nga autoriteti kompetent, në përputhje me kuadrin ligjor dhe ndarjen e kompetencave ndërmjet institucioneve. Në këtë kuadër, vlerësimi i ERE-s kufizohet në verifikimin e përmbushjes së kriterit ligjor të pajisjes me dokumentacionin mjedisor përkatës, pa u shtrirë në rivlerësimin teknik të kushteve dhe parametrave mjedisorë të aktivitetit, të cilët janë objekt i kompetencave të autoritetit përgjegjës për mjedisin dhe monitorimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në aktet përkatëse.
- Për sa kohë aktet mjedisore janë lëshuar nga autoriteti kompetent dhe rezultojnë në fuqi, pa qenë të pezulluara apo shfuqizuara, ato përbëjnë dokumentacion të vlefshëm për qëllimet e kësaj procedure licencimi. Për rrjedhojë, pretendimet lidhur me emetimet, shkarkimet, zhurmat, cilësinë e ujërave apo ndikime të tjera konkrete në mjedis, të cilat kërkojnë një vlerësim teknik të aktivitetit, nuk mund të përbëjnë, në vetvete, shkak për mospranimin e licencimit, në mungesë të një akti të autoritetit kompetent që konstaton shkelje të kushteve mjedisore ose cenim të vlefshmërisë së dokumentacionit përkatës.
- Gjithashtu, në këtë vlerësim merret në konsideratë fakti se shoqëria është pajisur së fundmi me lejen mjedisore përkatëse, e cila rezulton në fuqi dhe përbën dokumentin aktual të vlefshëm për përmbushjen e këtij kriteri në referencë të përcaktimeve të nenit 9, pika 2.1, gërma "e" të Rregullores. Gjithsesi, ERE do të njoftojë AKM-në për vendimmarrjen e saj.

Objeksione lidhur me kostot financiare, eficiencën dhe planifikimin ekonomik të projektit
Pretendimet e palëve

- Në lidhje me aspektin ekonomik dhe financiar të projektit, në objeksionet e paraqitura është pretenduar se TEC-et lundruese "Tigri 1" dhe "Tigri 3" kanë kosto të larta për buxhetin e shtetit dhe taksapaguesit, ndërsa efektiviteti i tyre në prodhimin e energjisë elektrike është i ulët ose i papërfillshëm. Gjithashtu, është ngritur pretendimi se prodhimi i energjisë nga këto asete nuk është ekonomikisht konkurrues me alternativat e furnizimit në treg dhe se kostot e karburantit, operimit dhe mirëmbajtjes, përfshirë procedurat e prokurimit për këto shërbime, mund të sjellin ngarkesa financiare për KESH sh.a. dhe, në fund, për konsumatorët.
- Në këtë kuadër, është kërkuar transparencë dhe një vlerësim i pavarur i kostos dhe detyrimeve financiare që burojnë nga kontratat dhe operimi i këtyre aseteve. Në disa objeksione është kërkuar që këto elemente të merren në konsideratë edhe në vlerësimin e licencimit, duke u pretenduar se miratimi i licencës dhe njohja e kostove operative, në kushtet e një aktiviteti të konsideruar me efektivitet të ulët, do të mund të rëndonte mbi financat publike dhe tarifat e energjisë për konsumatorët.

Parashtrimet e KESH sh.a. në lidhje me objeksionet/çështjet e sipërcituara

- Në lidhje me burimin e financimit/mbështetjen financiare, KESH sh.a. sqaron se financimi për operimin e TEC Lundrues Vlorë është sigumar nga të ardhurat e shoqërisë KESH sh.a., në përputhje me planifikimin financiar të miratuar.
- Në këtë kuadër, është depozituar pranë ERE-s "*Programi Ekonomiko-Financiar për vitin 2026 dhe parashikimin për periudhën 2027-2030*", miratuar me Vendimin nr. 1, datë 19.01.2026 të Këshillit Mbikëqyrës së KESH sh.a. dhe Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 1212/1, datë 06.02.2026, si dhe Plani i Biznesit.

- Në dokumentacionin e depozituar, konkretisht në Kapitullin II "Shpenzime gjithsej", rubrika IX, zëri "Shpenzime aseti gienerues termik", faqe 8, janë pasqyruar shpenzimet e planifikuara për operimin e TEC Lundrues Vlorë, te cilat dëshmojnë mbështetjen financiare të siguruar.

Qëndrimi i ERE-s në lidhje me me objeksionet/çështjet e sipërcituara

- Nga shqyrtimi i pretendimeve të paraqitura në objeksione dhe i dokumentacionit të administruar gjatë kësaj procedure, rezulton se ato nuk gjejnë mbështetje në rrethanat faktike dhe kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Konkretisht, nevoja për operimin dhe mirëmbajtjen e aseteve gjeneruese termike lidhet me përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik nga KESH sh.a., pasi neni 5, pika 3, i VKM-së nr. 456, datë 29.06.2022, të ndryshuar, përcakton shprehimisht se, për sigurimin e të gjitha sasive të nevojshme për Furnizuesin e Shërbimit Universal, shoqëria publike e prodhimit, përveç shfrytëzimit të aseteve gjeneruese në pronësi, ka të drejtë, sipas nevojës, të kontraktojë asete të tjera gjeneruese dhe të përdorë mekanizma të tjerë për sigurimin e energjisë elektrike. Sa më sipër, rezulton se kuadri nënligor i njeh KESH sh.a. mundësinë e përdorimit të një kombinimi mekanizmash për sigurimin e energjisë së nevojshme për përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik, duke përfshirë shfrytëzimin e aseteve gjeneruese në pronësi dhe kontraktimin e kapaciteteve të tjera gjeneruese.
- Gjithashtu, lidhur me ndryshimin e natyrës juridike të aseteve, MIE, në përgjigje të kërkesës së ERE-s, ka konfirmuar se kalimi i pronësisë së tyre te KESH sh.a. është i parashikuar shprehimisht në kontratat përkatëse dhe nuk përbën dhënie të një të drejte të re për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese apo të depozitimit të energjisë, duke mos evidentuar nevojën për një autorizim të ri për këtë qëllim.
- Sa i përket pretendimit për ndikimin e kostove të TEC-eve në çmimet e energjisë për konsumatorët fundorë, nga shqyrtimi i vendimeve të ERE-s për çmimin e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët e FSHU-së për vitet 2024, 2025 dhe 2026, nuk rezulton të jetë identifikuar një pasqyrim i drejtpërdrejtë dhe i veçantë i këtyre kostove në çmimin e miratuar për këtë kategori konsumatorësh. Për sa i përket pretendimeve financiare, nga dokumentacioni i administruar rezulton se kostot e aktivitetit dhe burimi i financimit të tyre janë pasqyruar në Programin Ekonomiko-Financiar dhe Planin e Biznesit të shoqërisë, të miratuara nga organet kompetente të saj.
- Sa i përket pretendimit për ndikimin e këtyre kostove në çmimet e energjisë për konsumatorët fundorë, rezulton se referuar vendimeve të ERE-s për miratimin e cmimit e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, përkatësisht për vitin 2024 (Vendimi i bordit të EREs nr. 366, datë 15.12.2023 & Vendimi nr. 72, datë 15.04.2024), për vitin 2025 (Vendimi nr. 298, datë 30.12.2024 & Vendimi nr. 10, datë 08.01.2025) dhe vitin 2026 (Vendimi nr. 322, datë 15.12.2025), gjatë kohës kur TEC-et lundruese kanë qenë të kontraktuara/licencuara duke filluar nga viti 2024, nuk evidentohet një ndikimi i tyre në çmimin e miratuar për këtë kategori konsumatorësh.
- Po kështu, vlera e parashikuar për operimin dhe mirëmbajtjen e aseteve rezulton në përputhje me parashikimet e Planit të Biznesit të depozituar pranë ERE-s, ndërsa vlerësimi i ligjshmërisë dhe rregullsisë së procedurës së prokurimit, përfshirë përcaktimin e fondit limit, nuk përfshihet në kompetencat e ERE-s. Për rrjedhojë, pretendimet e paraqitura nuk gjejnë mbështetje në dokumentacionin e administruar dhe nuk provojnë ekzistencën e ndonjë ndikimi financiar apo tarifor që të cenojë vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur dhe plotësimin e kushteve ligjore e rregullatore për licencimin e shoqërisë në kuadër të kësaj procedure.
- ERE vlerëson se shqyrtimi i pretendimeve lidhur me emetimet, shkarkimet në ujë, zhurmat, biodiversitetin dhe ndikimin në shëndetin publik duhet të bëhet në respektim të ndarjes ligjore të kompetencave. Në kuadër të procedurës së licencimit, ERE verifikon nëse aplikuesi ka

paraqitur aktet dhe lejet që kërkohen nga legjislacioni për ushtrimin e veprimtarisë, si dhe nëse këto akte rezultojnë të vlefshme në momentin e vendimmarrjes. Kontrolli i respektimit të kushteve të lejes, monitorimi i parametrave mjedisorë dhe marrja e masave në rast shkeljesh mbeten në kompetencë të autoriteteve përgjegjëse sipas legjislacionit mjedisor.

Objeksione lidhur me ligjshmërinë e akteve administrative
Pretendimet e palëve

- L. F. ngre pretendimin se aktet administrative mbi të cilat është filluar procedura e licencimit dhe do të shqyrtohet vendimmarrja për licencimin e shoqërisë janë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe ende nuk ka një vendim të formës së prerë për paligjshmërinë e tyre. Ai pretendon se dekalrata mjedisore, leja mjedisore e tipit A, leja për përdorimin e burimit ujor, si dhe të gjitha aktet e tjera të nxjerra në zbatim të kësaj procedure janë të paligjshme, si rrjedhojë dhe vendimmarrja për licencimin e shoqërisë dhe ushtrimin e veprimtarisë mbi akte të paligjshme do t'i shkaktojë dëm të rëndë dhe të pariparueshëm mjedisit. Pretendimet lidhen me faktin se këto janë të paligjshme, pasi disa prej tyre janë nxjerrë në zbatim të akteve normative që kanë qenë të shfuqizuara në kohën e miratimit ose të testimit të aseteve, ndërkohë që nuk ka ekzistuar më gjendja e emergjencës energjetike që kishte shërbyer si një nga bazat e ndërhyrjes. Po ashtu, ngrihen pretendime mbi paligjshmërinë e procedurës së marrjes me qira dhe përzgjedhjes së TEC-eve lundruese, për shkak të mungesës së një vlerësimi mbi alternativat e tjera të prodhimit, përdorimin e karburantit të lëngshëm, vendndodhjen e aseteve dhe ndikimet përkatëse, si dhe për shkak të pretendimeve mbi mungesën e transparencës së kësaj procedure.
- Sa i përket dokumentacionit mjedisor, është pretenduar se Deklarata Mjedisore është miratuar në kundërshtim me kërkesat materiale dhe procedurale, përfshirë rregullat e njoftimit dhe konsultimit publik, dhe se ekzistojnë mospërputhje apo mangësi ndërmjet dokumenteve të VNM-së dhe akteve mjedisore të miratuara. Po ashtu, është kundërshtuar vlefshmëria e Lejes Mjedisore të Tipit A, duke u pretenduar se ajo është miratuar pa rivlerësuar kushtet ekzistuese në kohën e lëshimit, mbi një bazë normative të kundërshtuar dhe pa përmbushjen e kërkesave për konsultim publik, si dhe se vlefshmëria e saj lidhet me afatin e kontratës së qirasë së aseteve. Për rrjedhojë, është pretenduar se, pas kalimit të aseteve në pronësi të KESH sh.a., duhet të kryhet një procedurë e re mjedisore, përfshirë vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe konsultimin me publikun, përpara licencimit dhe ushtrimit të veprimtarisë.

Parashtrimet e KESH-it në lidhje me objeksionet/çështjet e sipërcituara

- Në lidhje me sa më sipër, KESH sh.a. ka referuar se këto objeksione i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësore në formën e pretendimeve gjyqësore, përmes kërkesë-padisë për të cilat gjykata ka disponuar me vendimin nr. 3600, datë 23.10.2025.

Qëndrimi i ERE-s në lidhje me objeksionet/çështjet e sipërcituara

- Nga shqyrtimi i pretendimeve të paraqitura dhe dokumentacionit të administruar, rezulton se nuk evidentohen rrethana faktike apo ligjore që të përbëjnë pengesë për vijimin e procedurës së licencimit. Konkretisht, aktet administrative të kundërshtuara kanë qenë objekt shqyrtimi gjyqësor, ku Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 3600, datë 23.10.2025, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, ndërkohë që nuk rezulton të ketë një vendim gjyqësor të formës së prerë që të ketë konstatuar paligjshmërinë e tyre. Për më tepër, gjatë shqyrtimit të aplikimit, KESH sh.a. ka depozituar Lejen e re Mjedisore të Tipit A, nr. 5216 prot., datë 23.09.2026, të lëshuar nga autoriteti kompetent mjedisor, duke përditësuar dokumentacionin mjedisor në përputhje me statusin e ri juridik të aseteve. Në këtë kuadër, ERE verifikon

ekzistencën dhe vlefshmërinë formale të dokumentacionit të kërkuar për licencim, ndërsa vlerësimi i ligjshmërisë së procedurave dhe kushteve për lëshimin e akteve mjedisore u përket autoriteteve kompetente. Gjithashtu, përdorimi i aseteve gjeneruese të kontraktuara nga KESH sh.a. mbështetet në parashikimin e nenit 5, pika 3, të VKM-së nr. 456/2022, të ndryshuar, i cili i njeh shoqërisë publike të prodhimit të drejtën të kontraktojë asete të tjera gjeneruese, sipas nevojës, për përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik. Ndërkohë, lidhur me kalimin e pronësisë së aseteve, MIE ka konfirmuar se ky ndryshim është parashikuar shprehimisht në kontratat përkatëse dhe nuk përbën dhënie të një të drejte të re për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese apo të depozitimit të energjisë, në kuptim të nenit 52 të ligjit nr. 59/2026. Për rrjedhojë, pretendimet e paraqitura, përfshirë ato mbi paligjshmërinë e akteve mjedisore dhe procedurës së kontraktimit të aseteve, nuk provojnë, në kushtet e dokumentacionit aktualisht të administruar, mospërmbushjen e kritereve ligjore dhe rregullatore për licencim dhe, për rrjedhojë, nuk përbëjnë shkak për refuzimin e aplikimit nga ERE.

Objeksione lidhur me kriteret e licencimit dhe kompetencën e ERE-s

Pretendimet e palëve

- L. F., me shkresën nr. 2110/11 prot., datë 03.08.2026, duke iu referuar kritereve të përcaktuara në nenin 38 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pretendon se këto kritere nuk janë analizuar në vendimmarrjen e ERE-s për licencimin e KESH sh.a. Konkretisht, ai ngre çështje që lidhen me vendndodhjen e impianteve, sigurinë operative, natyrën e burimeve parësore të energjisë, sigurinë dhe shëndetin publik, kërkesat financiare, mbrojtjen e mjedisit, efiçencën e energjisë, detyrimet e shërbimit publik dhe konkurrencën në treg. Gjithashtu, pretendon se përdorimi i lëndëve djegëse të deklaruara nga shoqëria bie ndesh me parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe cenon shëndetin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve.

Qëndrimi i ERE-s në lidhje me objeksionet/çështjet e sipërcituara

- ERE sqaron se kriteret e përcaktuara në nenin 38 të ligjit nr. 43/2015 janë marrë në konsideratë gjatë shqyrtimit të aplikimit të KESH sh.a. për licencimin e TEC-eve lundruese "Tigri 1" dhe "Tigri 3", në raport me natyrën e veprimtarisë, karakteristikat e impianteve dhe dokumentacionin teknik, financiar, administrativ dhe mjedisor të administruar gjatë procedurës.
- Në këtë kuadër, është shqyrtuar dokumentacioni mjedisor, leja për përdorimin e burimit ujor, dokumentacioni teknik dhe marrëveshja e lidhjes me rrjetin e transmetimit, si dhe dokumentacioni financiar që pasqyron burimet e financimit dhe kostot e parashikuara për ushtrimin e aktivitetit.
- Lidhur me përdorimin e naftës së rëndë dhe të lehtë, ERE vlerëson se kjo karakteristikë teknologjike nuk përbën, në vetvete, ndalim për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, por duhet të jetë në përputhje me standardet teknike dhe detyrimet mjedisore në fuqi. Për këtë qëllim, është shqyrtuar dokumentacioni mjedisor dhe, pas ndryshimit të statusit juridik të aseteve, është verifikuar vlefshmëria e lejeve përkatëse pranë autoritetit kompetent. Procedura u pezullua me vendimin e Bordit nr. 254, datë 03.09.2026, deri në administrimin e qëndrimit të AKM-së, ndërsa në vijim KESH sh.a. depozitoi Aktin e Miratimit të Lejes së Mjedisit Tipi A dhe dokumentacionin për përmbushjen e detyrimeve të saj.
- ERE thekson se monitorimi i emetimeve, shkarkimeve në ujë, ndikimeve në biodiversitet, zhurmave dhe shëndetit publik, si dhe kontrolli i respektimit të kushteve të lejes mjedisore, janë kompetenca të autoriteteve përgjegjëse mjedisore.
- Gjithashtu, nevoja për disponueshmërinë e kapaciteteve gjeneruese është vlerësuar në raport me detyrimet e KESH sh.a. në kuadër të shërbimit publik. Në këtë drejtim, VKM nr. 456, datë 29.06.2022, e ndryshuar, parashikon mundësinë e përdorimit të aseteve të tjera gjeneruese për përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik dhe sigurimin e energjisë elektrike.

- Së fundi, ERE sqaron se dhënia e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nuk përbën miratim të mënyrës së shfrytëzimit të impianteve, të kostove të prodhimit apo të transaksioneve që shoqëria do të kryejë në treg. Ushtrimi i kësaj veprimtarie mbetet subjekt i kërkesave teknike, rregullave të operimit dhe rregullave të tregut të energjisë elektrike, të cilat zbatohen nga subjektet pjesëmarrëse në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.
- Në përfundim, nga analiza e dokumentacionit të paraqitur në kuadër të aplikimit, shqyrtimi i qëndrimeve të institucioneve dhe organeve kompetente, verifikimi i vlefshmërisë dhe përputhshmërisë ligjore të lejeve, miratimeve dhe autorizimeve përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë, si dhe shqyrtimi i objeksioneve të paraqitura, të cilat nuk rezultojnë të mbështetura në rrethana apo argumente që të pengojnë vijimin e procedurës së licencimit, vlerësohet se janë përmbushur kërkesat ligjore dhe rregullatore për licencim. Për rrjedhojë, vlerësohet të vijojë procedura për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Referuar dokumentacionit teknik të depozituar nga shoqëria, rezulton se jetëgjatësia e pritshme e impianteve është vlerësuar 5 (pesë) vjet, por nëse ndiqet një regjim përdorimi të vazhdueshëm prej 24 orësh në ditë për një periudhë 2 (dy)vjeçare, jetgjatësia është dy vjet. Nga raportimet periodike të paraqitura nga shoqëria pranë ERE-s rezulton se, që prej vënies në operim të impianteve, ato nuk kanë funksionuar në mënyrë të vazhdueshme sipas këtij regjimi operimi.
- Për rrjedhojë, ERE vlerëson se përcaktimi i kohëzgjatjes së licencës duhet të marrë në konsideratë vlerësimin e jetëgjatësisë së pritshme teknike të impianteve, të pasqyruar në Oponencën Teknike të Institutit të Ndërtimit, si dhe regjimin e operimit mbi bazën e të cilit është kryer ky vlerësim dhe vlefshmëria e saj të jetë 5 (pesë) vjet.
- Në rast se impianti operon në mënyrë të vazhdueshme, 24 orë në ditë, për një periudhë prej 2 (dy) vitesh, licenca përfundon me plotësimin e kësaj periudhe dyvjeçare.
- Po ashtu, duke qenë se plani financiar i depozituar nga shoqëria mbulon periudhën 2026-2030 dhe nuk përfshin të gjithë periudhën e vlefshmërisë së licencës, vlerësohet e nevojshme që shoqërisë t'i lihet detyrë të depozitojë në ERE parashikimin financiar për periudhën e mbetur të licencës, në përputhje me programin ekonomik dhe financiar të aktivitetit të licencuar, kjo edhe në përputhje me rakordimin e kohës së operimit të centralit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (Sh.a KESH)" sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga TEC-et Lundruese "Tigri 1", me kapacitet të instaluar 50 MW, dhe "Tigri 3", me kapacitet të instaluar 60 MW, me vendndodhje në Portin e Triportit, në Gjirin e Vlorës, për një afat 5-vjeçar.

2. Në rast se impianti operon në mënyrë të vazhdueshme, 24 orë në ditë, për një periudhë prej 2 (dy) vitesh, licenca përfundon me plotësimin e kësaj periudhe dyvjeçare.

3. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujor brenda datës 15.03.2028.

4. Ky vendim është objekt rishikimi në kuadër të sa parashikuar në pikën 2 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të akteve apo dokumenteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë për vendimin e bordit të ERE-s shoqërinë "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (SH.A KESH)" sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqërinë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a., dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), si dhe palët e treta që kanë paraiqtur objeksione.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI